

	<b>KOMENTE</b>	<b>FO-ÇLRR-025</b>
	<i>ver. 1.1</i>	<i>fajë 1 nga 7</i>

07.09.2018

## Komente lidhur me: Raportin Konsultativ për MAR të KOSTT 2018-2022 dhe Raportin Konsultativ për Faktorin e Efikasitetit

*Çështja për komentim:*

- 1. Metodologjia e rregullimit**
- 2. Faktori i efikasitetit**
- 3. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes PRR2**
- 4. Kostot e humbjeve**
- 5. Shërbimet ndihmëse**
- 6. Kostot kapitale PRR2**
- 7. Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe PRR1**
- 8. Kërkesa finale e KOSTT**

*Komentimi:*

### **1. Metodologjia e rregullimit**

KOSTT ka shqyrtuar metodologjinë e rregullimit e cila është aplikuar gjatë përpilimit të raporteve konsultative për MAR dhe për faktorin e efikasitetit, në raport me rregullat dhe metodologjitë në fuqi dhe konstaton se në këtë aspekt nuk ka ndonjë vërejtje.

Megjithatë, qasja e përdorur për përcaktimin e disa elementeve të cilat do t'i shqyrtojmë në vazhdim është e dëmshme për kompaninë në aspektin financiar dhe paraqet rrezik për periudhën e ardhshme rregullative.

### **2. Faktori i efikasitetit**

Vendosja e faktorit të efikasitetit prej 1.5% ndaj shpenzimeve operative, në një situatë ku faktori i periudhës së kaluar ka qenë tejet i lartë dhe si pasojë ka dëmtuar financiarisht kompaninë, duke krijuar mungesë të dukshme të fondeve të për operim është i papranueshëm.

Gjithashtu, baza e përcaktuar për këto shpenzime është shumë e ulët të cilën do ta trajtojmë në vazhdim.

Andaj KOSTT duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar në PRR1 nga aplikimi i faktorit të lartë të efikasitetit si dhe dëmin që do t'i shkaktojë aplikimi i çfarëdo faktori në PRR2 bazuar në

faktin se kompania veç se operon me një efikasitet të dukshëm, kërkon që për PRR2 ZRrE mos të aplikojë fare faktor të efikasitetit ndaj shpenzimeve operative të kompanisë.

### 3. Kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes PRR2

Kategoria e operimit dhe mirëmbajtjes ka qenë kategoria në të cilën KOSTT-it i është shkaktuar dëmi më i madh në PRR1, duke lejuar nivele tejet të ulëta të të hyrave për këto kategori. Kjo ka rezultuar me mungesa të mëdha financiare në këto vija buxhetore e si pasojë me vështirësi të operimit të kompanisë në baza ditore dhe shkurtime të mëdha buxhetore, në vija vitale siç është zhvillimi dh trajnimi i stafit të kompanisë.

I njëjti trend i lejimit të të hyrave për operim dhe mirëmbajtje po shihet sa ka vazhduar edhe për PRR2. Kjo qasje ndaj kësaj kategorie e dëmton seriozisht operimin e kompanisë në baza ditore dhe e vë në rrezik mbarëvajtjen e zhvillimit të kompanisë dhe mirëmbajtjen e cilësisë dhe vlerave të kultivuara deri më tani.

KOSTT me vështirësi të mëdha ka zvogëluar shpenzimet operative me qëllim të arritjes së faktorit të efikasitetit të përcaktuar për PRR1, por kjo ka qenë e pamundur. Si pasojë e përpjekjeve të vazhdueshme kemi arritur që dy vitet, e fundit e sidomos vitin 2017 të bëjmë një zvogëlim pothuajse arbitrare i cili mund të realizohet vetëm në një vit dhe nuk është trend i cili mund të mbahet më gjatë. Gjatë këtij viti siç mund të shihet edhe nga detajet e pasqyrave financiare dhe dokumenteve të dërguara në ZRrE, trajnimet dhe zhvillimet e stafit pothuajse janë ndërprerë, furnizimet me materiale dhe shërbime janë zvogëluar deri në nivele të pa arsyeshme e kështu me radhë. Me gjithë këto përpjekje prapë nuk është arritur caku i faktorit të efikasitetit për periudhën e parë.

Tabela 1. Shpenzimet Operative 2013-2017

SHPENZIMET OPERATIVE	2013			2014			2015			2016			2017		
	Lejuar	Realizuar	%	Lejuar	Realizuar	%	Lejuar	Realizuar	%	Lejuar	Realizuar	%	Lejuar	Realizuar	%
2013 - 2017															
<b>TOTALI</b>	7,222	7,370		7,039	7,616	108%	6,854	7,435	108%	6,642	7,379	111%	6,453	6,942	108%
Riparime dhe Mirëmbajtje	1,618	1,050	65%	1,553	813	52%	1,491	613	41%	1,430	752	53%	1,371	686	50%
Shpenzime tjera Operative	5,604	6,320	113%	5,486	6,803	124%	5,363	6,822	127%	5,212	6,627	127%	5,083	6,256	123%

Nga tabela mund të shihet se niveli i lejuar i shpenzimeve operative ka qenë shumë i ulët dhe i pa arritshëm.

Realizimi i vitit 2017 ka qenë anomali e arritur me shkurtime të pa arsyeshme të shpenzimeve dhe si i tillë ka qenë i dëmshëm për zhvillimin e kompanisë. Këtu ndikim të madh ka pasur edhe zvogëlimi i tarifave prej 44% dhe gjendja e rëndë financiare me ç'rast janë ndërprerë shpenzimet operative në mënyrë drastike.

ZRrE në raportin e lëshuar për PRR2 ka paraqitur vlerat e propozuara të operimit dhe mirëmbajtjes në nivele të papranueshme për KOSTT.

Fillimisht kërkesa e KOSTT nuk është marrë parasysh si kërkesë e plotë si pasojë e ndonjë gabimi teknik apo çfarëdo arsye tjetër, dhe paraqitet më e vogël se sa në fakt ka qenë.

Në tabelën më poshtë po e ri paraqesim kërkesën për kategorinë e shpenzimeve tjera operative.

Tabela 2. Detajet e kërkesës për shpenzimet tjera operative

Detajet e Shpenzimeve tjera operative	2018	2019	2020	2021	2022
<b>TOTALI</b>	<b>2,672.70</b>	<b>2,754.20</b>	<b>2,878.20</b>	<b>2,744.20</b>	<b>2,741.20</b>
Vajra dhe lubrifikante	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Udhëtime zyrtare	210.00	210.00	210.00	210.00	210.00
Sigurimi fizik	200.00	200.00	200.00	200.00	200.00
Materiale dhe inventarë i imët	51.00	51.00	51.00	51.00	51.00
Komunal	472.00	476.00	480.00	484.00	488.00
Këshilla juridike për ENTSO-e	100.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Tatimi në pronë dhe të tjera	75.00	75.00	75.00	75.00	75.00
Shërbime shëndetësore	15.00	15.00	15.00	15.00	15.00
Sigurimi i veturave	36.00	43.00	43.00	43.00	43.00
Shërbime bankare	9.00	9.00	9.00	9.00	9.00
Shpenzime të antarësimeve	9.00	8.50	138.50	138.50	138.50
Trajnimet	150.00	150.00	150.00	150.00	150.00
Kompensimi i pronareve per demet eventuale	20.00	20.00	20.00	20.00	20.00
Sherbime për RSC (Regional Security Coordination)	100.00	340.00	340.00	340.00	340.00
Auditimi i pasqvrave financiare	8.00	5.00	5.00	10.00	10.00
Praktika profesionale për studentë	30.00	15.00	15.00	15.00	15.00
Sherbimet per CAO	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Tarifë trevjeçare për licencë të shfrytëzimit të brezit frekuencor për sistemin radio komunikues.	0.00	0.00	10.00	0.00	0.00
Shpenzimet operative te operimit te Tregut te perbashket	200.00	162.00	132.00	9.00	0.00
Detyrimi për shfrytëzim të hapsirës për repetitorë dhe antena për sistemin radio komunikues.	18.00	18.00	18.00	18.00	18.00
Shpenzimet juridike dhe financiare	25.00	10.00	20.00	10.00	10.00
Shpenzimet për shpërblime dhe rekreacion	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00
Ndihmë solidare punëtorëve	20.00	20.00	20.00	20.00	20.00
Përkthimi dhe redaktimi i dokumenteve publike	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00
Sigurimi aksidental personal	30.00	30.00	30.00	30.00	30.00
Shpenz.kadastrale dhe juridike për bartjen e pronës.së aseteve 110 kV nga KEK	50.00	50.00	50.00	50.00	50.00
Sigurimi i aseteve të KOSTT	450.00	450.00	450.00	450.00	450.00
Pagesa vjetore e lidhjes së internetit dhe domenit për operimin e tregut	0.80	0.80	0.80	0.80	0.80
Marketing(mat.promovues)	30.00	30.00	30.00	30.00	30.00
Reprezentacioni	60.00	60.00	60.00	60.00	60.00
Interneti dhe tv.kablovik	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00
Shpenzimet jo afariste	5.00	5.00	5.00	5.00	5.00
Përgjegjësia Shoq.Korporative	3.00	5.00	5.00	5.00	7.00
Tarifat vjetore për shfrytëzimin e internetit SIP dhe domeni i ri	12.00	12.00	12.00	12.00	12.00
Ofertuesi i II-të i shpenz.të internetit	1.90	1.90	1.90	1.90	1.90
Parapagimi për shtypin vendor dhe ndërkombëtar	3.00	3.00	3.00	3.00	3.00
Furnizimi me pajisje për mbrojtje në punë	35.00	35.00	35.00	35.00	35.00
Financimi i funksionalizimit te CIGRE Kosova	10.00	10.00	10.00	10.00	10.00

Gjithashtu, trajtimi i disa zërave të shpenzimeve tjera operative si fond i veçantë për anëtarësime në organizata ndërkombëtare nuk është vlerësuar korrekt, pasi që pjesa më e madhe e këtyre kostove parashihet të jetë kosto për trajnime dhe zhvillim të stafit dhe pjesëmarrje në grupet punuese që ndërlidhet me proceset e anëtarësimeve në ato organizata, kurse një pjesë e vogël për pagesa fikse të anëtarësimeve. Andaj, kjo vijë buxhetore nuk do të duhej të ndahej nga shpenzimet tjera operative e as të trajtohet si pagesë e anëtarësimeve sepse nuk është e tillë.

ZRRrE duhet të ketë parasysh se periudha zhvillimore që e pret KOSTT-in, si anëtarësimi në ENTSO-E, tregu i përbashkët Kosovë – Shqipëri, CAO, RGCE, integrimi i burimeve të ripërtitshme, Smart Grid, Cyber Security që ndërlidhet me IT dhe SCADA, e shumë zhvillime tjera, do të kenë ndikim direkt në rritjen e shpenzimeve tjera operative për të cilat patjetër duhet të rritet niveli i propozuar nga ZRRrE.

Kategoria e shpenzimeve tjera operative, përmban kategori ligjore të cilat duhet të përmbushen patjetër dhe kanë një kosto të lartë, si sigurimi fizik i aseteve, sigurimi shëndetësorë, sigurimi i automjeteve etj. gjithashtu shërbimet komunale dhe ato përcjellëse të numrit të madh të objekteve të KOSTT kanë një kosto të lartë.

Në kategorinë e pagave duhet të përfshihen edhe pagat për operatorët e NS Vallaq, për të cilët KOSTT ka kërkesën e paraqitur nga Kryeministri i Kosovës për përfshirjen e këtyre punëtorëve në sistemin e pagave të KOSTT, meqë nënstacioni Vallaq është pronë e KOSTT-it.

Gjithashtu KOSTT nga viti 2018, do t'i trajton pagat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve nga komponenta e WACC-ut, pasi që ata nuk janë pjesë e personelit të KOSTT, por të emëruar të Qeverisë së Kosovës dhe si të tillë nuk do të duhej të paguhen nga konsumatorët e Kosovës.

Me qëllim të vazhimit të zhvillimit të rrjetit transmetues, zhvillimit të kuadrove të kompanisë, cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve në dobi të konsumatorëve të Kosovës, KOSTT kërkon që propozimi i KOSTT për kategorinë e operimit dhe mirëmbajtjes të pranohet i plotë dhe pa shkurtime të cilat do të rezultojnë të dëmshme ashtu si në periudhën e parë. Më poshtë paraqitet totali i kërkesës për operim dhe mirëmbajtje.

Tabela 3. Kërkesa e KOSTT për shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes 2018-2022

<b>APLIKIMI KOSTT 2018-2022</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>TOTALI</b>	<b>9,702.80</b>	<b>10,157.38</b>	<b>10,205.74</b>	<b>10,237.84</b>	<b>10,627.17</b>
<b>Riparime dhe Mirëmbajtje</b>	<b>1,191.00</b>	<b>1,327.00</b>	<b>1,045.00</b>	<b>967.00</b>	<b>1,042.00</b>
<b>Shpenzime tjera Operative</b>	<b>8,511.80</b>	<b>8,830.38</b>	<b>9,160.74</b>	<b>9,270.84</b>	<b>9,585.17</b>

#### **4. Kostot e humbjeve**

Zvogëlimi i humbjeve në rrjetin e transmetimit që nga themelimi i KOSTT e deri më tani është një ndër sukseset e dukshme dhe të prekshme të kompanisë. KOSTT në vazhdimësi ka paraqitur fakte dhe analiza se niveli aktual i humbjeve është niveli më i ulët i mundshëm dhe trendi i tyre si pasojë i zgjerimit të rrjetit do të merr kahje tjetër dhe do të fillon të rritet në të ardhmen.

Prandaj, KOSTT dëshiron të vejë në pah se caku i përcaktuar nga ZRrE për humbjet e transmetimit prej 1.78%, paraqet një rrezik real dhe do të jetë vështirë i arritshëm.

#### **5. Shërbimet ndihmëse**

Në raportin e lëshuar ZRrE ka marrë parasysh vetë njërin komponentë të shërbimeve ndihmëse, atë të rezervës sekondare duke eliminuar në tërësi të hyrat për kostot e rezervës terciare. Ashtu siç ceket edhe në raport KOSTT ka argumentuar kërkesat e veta për këtë rezervë, mirëpo ZRrE për shkak të situatës politike i ka hedhur poshtë.

KOSTT dëshiron të vejë në pah se mos përfshirja e të hyrave për rezervën terciare në tërësi e rrezikon procesin e anëtarësimit në ENTSO-E, për të cilën pjesë është i obliguar të ketë mbulesë financiare.

Andaj, duke reflektuar me të njëjtën qasje me ZRrE, KOSTT paraqet kërkesën për rezervën terciare me 50% të vlerës së parashikuar për këtë rezervë. Kurse pjesa e pambuluar mbetet të mbulohet gjatë përshtatjeve të rregullta vjetore.

Gjithashtu, kjo kërkesë është në përputhje me përmbushjen e obligimeve që dalin nga Procedura për Prokurimin e Humbjeve, në bazë të së cilës KOSTT ka për detyrë me balancu sistemin në kohë reale duke blerë rezervën terciare në treg për mbulimin e rënive të njësive gjeneruese në vend. Kjo gjithashtu është në përputhje edhe me kërkesat e ZRrE që të mos ketë reduktime të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve.

Tabela 4. Kërkesa për rezervën terciare

Rezervat Terciare	2018	2019	2020	2021	2022
Propozimi fillestaar i KOSTT	6,832	6,832	6,832	6,832	6,832
Propozimi I ZRRE-së	0	0	0	0	0
Propozimi final i KOSTT	3,416	3,416	3,416	3,416	3,416

## 6. Kostot kapitale PRR2

Në raportin konsultativ shihet se ZRrE ka larguar nga programi i investimeve të propozuar nga KOSTT disa projekte me arsyetimet e paraqitura në vijim:

- *Projekti me ID 010: Instalimi i TR2 (40 MVA) në NS 110/10(20) Klinë.* Analiza e Kost-Benefitit tregon se ky projekt ka neto përfitime negative, prandaj siç është propozuar është i paarsyeshëm.
- *Projekti me ID 012: Riparimi i linjës 110 kV Prizren 1—Prizren 3 dhe Projekti ID 013: Ndërtimi i linjës së re 110 kV Prizren 1—Prizren 2.* Alternativat me kosto më të ulët siç janë zëvendësimi i kabllave dhe instalimi i përçuesve me tension të Lartë, Përkulje të Ulët duhet të analizohet dhe të ofrohen dëshmi që propozimi i KOSTT-it është i pranueshëm.
- *Projekti me ID 017: Riparimi i NS Klina dhe NS Burimi.* Analiza e Kost-Benefitit tregon se ky projekt ka neto përfitime negative, prandaj siç është propozuar është i paarsyeshëm.
- *Projekti me ID 020: Instalimi i paneleve solare në nënstacione.* Ky projekt pritej të jetë tërësisht i financuar nga granti, mirëpo është i ndërlidhur me një investim të financuar përmes kredisë. Duke pasur parasysh këtë, kërkohet të jipen alternativa tjera krahasuese për projektet në fjalë.
- *Projekti me ID 022: Riparimi i pajisjeve të TL 110 kV në NS Vallaq.* Ky projekt pritej të jetë tërësisht i financuar nga granti, mirëpo është i ndërlidhur me një investim të financuar përmes kredisë. Duke pasur parasysh këtë, kërkohet të jipen alternativa tjera krahasuese për projektet në fjalë.

KOSTT ka argumentuar nevojën për zhvillimin e këtyre projekteve ashtu si edhe të gjitha projekteve tjera në planin investiv duke u bazuar në plotësimin e kërkesave të ligjeve dhe rregullave në fuqi, kriterit N-1, nevojave të konsumatorëve dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës, nevojave të zhvillimit të rrjetit dhe përmirësimit në ato pjesë ku është i vjetërsuar etj.

Në vazhdim po i ri paraqesim arsyetimet për projekte në fjalë.

***Projekti me ID 010: Instalimi i TR2 (40 MVA) në NS 110/10(20) Klinë***

- Ky projekt është i domosdoshëm për plotësimin e kriterit N-1, respektivisht mbajtjen e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve në përputhje me kërkesat ligjore dhe si i tillë duhet të përfshihet në programin e investimeve kapitale për PRR2.

***Projekti me ID 012: Riparimi i linjës 110 kV Prizren 1—Prizren 3 dhe Projekti ID 013: Ndërtimi i linjës së re 110 kV Prizren 1—Prizren 2***

- Linja e dyte e re në Prizren është me se e domosdoshme për plotësim të kriterit N-1, kjo është sqaruar në arsyetimin e detajuar dërguar më parë në ZRRE, gjithashtu siguria e operimit të nënstationeve për shkak të vjetërsisë së aseteve është faktori tjetër i cili argumenton se ky projektet duhet të mbetet në programin e investimeve kapitale.

***Projekti me ID 017: Riparimi i NS Klina dhe NS Burimi***

- Siguria e operimit të nënstationeve për shkak të vjetërsisë së aseteve është prioritet i këtij projekti andaj nuk duhet larguar nga programi.

***Projekti me ID 020: Instalimi i paneleve solare në nënstatione***

- Ky është investim me grant prandaj është me interes për KOSTT dhe konsumatorët që ky investim të realizohet, sepse kostoja është zero dhe kemi efikasitet. Gjithashtu, panelat solar do të duhej të përkrahen nga ZRRE, pasi hyn në kuadër të përkrahjes së BRE-ve dhe atë me ndikim pozitiv të konsumatori vendor, duke reduktuar konsumin e KOSTT.

***Projekti me ID 022: Riparimi i pajisjeve të TL 110 kV në NS Vallaq***

- Përveç sigurisë së sistemit që duhet të jetë prioritet për gjithë akterët e sistemit energjetik në vend edhe arsyet politike do të duhej të merren parasysh dhe ky projekt duhet të mbetet pjesë e programit.

Përveç arsyeve të cilat u përmenden deri më tani, gjithashtu ekzistojnë arsyet kontraktuale të cilat duhet të merren parasysh. Faza VI-VII e paket projekteve të financuara nga KfW, pjesë e të cilave janë edhe projektet ID 010, ID 012 dhe ID 017, negociimi i kësaj marrëveshje ka përfunduar dhe ka marrë miratimin e Qeverisë së Kosovës.

Ri negociimi i kësaj marrëveshje bart rreziqe të shumta duke filluar nga ECA Garancioni i cili për projektet e fazës VII është marrë përsipër nga Qeveria Gjermane dhe ri vënia e këtij garancioni do të ngritë koston e projekteve dhe si rezultat edhe tarifat e konsumatorëve, rrezikimin e projekteve tjera që janë pjesë e këtyre dy pakove deri te dështimi i komplet këtij procesi, e që kjo do të ishte në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Duke u bazuar në të gjitha këto, KOSTT kërkon nga ZRRE kthimin e të gjitha këtyre projekteve në listën e programit të investimeve kapitale për periudhën 2018-2022.

## 7. Përshtatjet e rregullta të vitit 2017 dhe PRR1

Në raport shihet se janë përfshirë të gjitha përshtatjet për PRR1 dhe përshtatjet e rregullta për vitin 2017, KOSTT ka analizuar me kujdes llogaritjet e tyre dhe nuk ka ndonjë vërejtje në këtë aspekt.

## 8. Kërkesa finale e KOSTT për MAR 2018-2022

Pas fakteve, komenteve dhe arsyetimeve të paraqitura deri më tani, KOSTT në vazhdim paraqet përmbledhjen e kërkesave në formë tabelare për elementet e MAR 2018-2022.

Tabela 5. Përmbledhje e kërkesës së KOSTT për MAR 2018-2022

TOTAL MAR KOSTT	2018	2019	2020	2021	2022
Baza Opex	9,702.80	10,157.38	10,205.74	10,237.84	10,627.17
Kosto e Humbjeve	4,368.66	4,153.73	4,115.30	4,110.48	4,102.05
Rezervat Sekondare	2,592.96	2,663.04	2,733.12	2,733.12	2,803.20
Rezervat Terciare	3416	3416	3416	3416	3416
Kthimi i Lejuar	8,496.81	9,220.34	9,728.75	9,767.71	9,527.51
Të hyrat jo-tarifore	-454.25	-454.25	-454.25	-454.25	-454
Fondi i burimeve të ripërtitshme	5,772.73				
Përshtatjet e vitit 2017	-137.10	-137.1	-137.1	-137.1	-137.1
Të hyrat e mbetura nga KEK (5 vite)	-3,329.34	-3,329.34	-3,329.34	-3,329.34	-3,329.34
<b>Totali</b>	<b>39,328.39</b>	<b>35,247.43</b>	<b>36,241.49</b>	<b>36,753.21</b>	<b>37,331.73</b>

Përgatitur nga: KOSTT